

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEPARTAMENTI PËR CËSHTJE EKONOMIKE, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, me procesmbajtësen Hamide Ademi, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit T. E. me seli në M.M. C., B. A. – T., të cilën e përfaqëson, K. S. avokat nga P., kundër të paditurit N.T.P.C. me seli në P., të cilën e përfaqëson R. B. avokat nga P., për shkak të borxhit, vlera e kontestit 16.984,44 €, në seancën e mbajtur më datë 23.04.2013 dhe me datë 29.04.2013 merrë këtë,

A K T G J Y K I M

SHFUQIZOHET Aktvendimi i kësaj Gjykate për lejimin e përmbarimit E.nr. 833/12, i dt. 20.11.2012, kështu që ky Aktvendim për borxhin kryesor, kamatën dhe shpenzimet, suprimohet në tërësi.

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “T. E.” me seli në B.A.-T..

DETYROHET e paditura “N.T.P C.” me seli në P. , që paditësit t’ia paguaj shumën prej 16.984,44 Euro (gjashtëmbëdhjetmijë e nëntëqind e tetëdhjetekatër dhe dyzetekatër cent), në emër të borxhit të mbetur me kamatë vjetore prej 3.5% duke llogaritur nga data e paraqitjes së padis të dt.16.11.2012 e deri në përmbushje definitive të këtij detyrimi.

DETYROHET e paditura N.T.P”C.” me seli në P. që t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 544.4 euro, në afatin prej 7 ditë nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Paditësi “T. E. me seli në A. – T. ka paraqitur propozim mbi lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit autentik , pranë kësaj Gjykate, kundër paditësit N.T.P “C.” me seli në P., duke kërkuar që t’ia paguaj pjesën e mbetur të borxhit në shumë prej 16.984,44 Euro, i cili borxh i është mbetur të siguruarit “P.” tek kompania e sigurimeve “T. E.”që paraqitet si paditës në këtë çështje juridike.

Kundër vendimit mbi lejimin e përmbarimit e paditura N.T.P“C.” me seli në Prizren në afatin ligjor ka paraqit kundërshtim ndaj aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit.

Gjykata duke u bazuar në nenin 58.4 të Ligjit mbi procedurën përmbarimore , e shfuqizojë aktvendimin e lart cekur E.nr.833/12 të dt 20.11.2012, dhe propozimin mbi lejimin e përmbarimit u konsiderua si padi.

E paditura me prapësim si dhe në shqyrtimin kryesor e ka kontestuar padin dhe kërkespadinë e paditësit duke cekur se paditësi nuk ka legjitimitet në këtë çështje civile-juridike për arsye se e paditura nuk ka dhe nuk ka pas kurfarë mardhënie kontraktuese me paditësin duke u thirë në nenin 899 të LMD –së . Njëherit e paditura ka shtuar se e ka përmbush në tërësi borxhi ndaj kompanis “P.” dhe se nuk ka kurfarë detyrimi ndaj saj.

Gjykata në shqyrtimin kryesor i administroj të gjitha provat e paraqitura nga palët ndërgjyqësore, i shqyrtoj ato , i analizoj s’bashku me pretendimet e palëvendërgjygjëse dhe e vërtetoi këtë gjendje faktike :

E paditura N.T.P “C.” me seli në Prizren ka pas mardhënie kontraktuse me kompanin “P.” lidhur me furnizimin me mallra si në faturën me nr.28501 te dt.17.11.2009.

E paditura e ka paguar një pjesë të cmimit të mallrave të pranuar kurse ka mbet borxh në shumë prej 16.984,44 Euro.

Kompania “P.” ka qenë e siguruar te paditësi për rrezikun e mos arktimit të borxheve ndaj afaristve të tyre e edhe ndaj paditurit. Kështu kompania “P.” për shumën e borxhit është kompenzuar nga paditësi si kompani e sigurimeve ashtu që borxhi i cekur tani është përcjell në “T. E.” me seli në A.-T. e që tani paraqitet si paditës.

Këtë gjendje faktike Gjykata e ka vërtetuar nga fatura e kompanis “P.” me nr.28501 e dt.17.11.2009, kushtet e përgjithshme të shitjes për p., polisa e përgjithshme për sigurim të kredisë së exportit ,letër kërkesë e përtritur me nr.2377108 e dt.13.04.2009, përfshirja e kontratës së sigurimit me nr.18343, përcaktimi i veprimit me nr.18343 e dt.16.05.2011, konformimi për lirimin e obligimeve me nr.18343 e dt.16.05.2011, garancioni i drejtorisë së përgjithshme të T. E. me nr 18343 të dt. 16.05.2011.

Nga fatura me nr. 28501 e dt.17.11.2009, Gjykata e vërtetoi faktin se e paditura e ka pranuar mallin e kontraktuar në shumë prej 24.059,78Euro, nga kompania “P.” me seli në A. –T. .

Nga prova “Kushtet e përgjithshme të shitjes për P., Gjykata ka vërtetuar se kompania P. ka kryer veprimatrin e vet ligjore nën kushtet e rregullat nën juridiksionin e T., dhe se ka pas autorizim të eksportoj mallëra nga T.. Njëherit edhe të bëjë sigurimin e kërkesave në rast të rezikut të mos arkëtimit të kërkesave me rastin e eksportimit të mallërave.

Nga prova e administruar (Polisa e përgjithshme e sigurimit të kredisë së eksportit) Gjykata ka vërtetuar faktin se kompania P. është siguruar për eksportet e veta tek paditësi –T. E. me seli në A. –T..

Po ashtu nga shkresat me të cilën është përsërit kërkesa ndaj të paditurit Gjykata e vërtetoi faktin se paditësi e ka fituar të drejtën që kërkesën e vet ta realizoj nëpërmes Gjykatës, ashtu sikurse e parashohin dispozitat e ligjit mbi Mardhënjet Detyrimore.

Nga kontrata e sigurimit me nr 18343, Gjykata ka vërtetuar faktin se gjitha kërkesat e të siguruarës janë siguruar tek paditësi i cekur më lartë.

Nga konformimi për lirimin nga obligimi me nr.18343 të dt 16.04.2011, Gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi T. E. ka kompenzuar kompania “P.” në shumë prej 16.984,44 Euro në bazë të kontratës mbi sigurimin e kërkesave.

Nga e gjitha këto prova dhe gjendja e vërtetuar faktike për shkruar më lartë rrjedh dhe pretendimet e të paditurës se paditësi nuk ka legjitimitet janë të pabazuar për këtë arsye:

Kompania P. në bazë të kontratës mbi sigurimin e mallërave të eksportuara dhe të kërkesave të saj nëse ato nuk realizohen janë siguruar tek paditësi-T. E. me seli në A.–T. , dhe se kjo bankë e sigurimeve në tërësi e ka kompenzuar të siguruarin e vetë (kompania P.) në shumë prej 16.984.44Euro

Kështu në bazë të kontratës mbi sigurimin – polisa e sigurimit të drejtat për kërkesën e përmbushjes së borxhit kreditorit “P.” janë përcjellë te Banka e sigurimit “T. E.” që do të thotë se është përcjell edhe legjitimiteti të cilën e ka kompania “P.”- neni 939.

Pretelemi tjetër e të paditurit se e ka përmbush në tërësi borxhin ndaj kreditorit-P. nuk qendron për arsye se me asnjë provë nuk e dëshmoj se e ka përmbush detyrimin e vet, dispozitat për përjashtimin e disa sigurimeve nga neni 899 të LMD-së nuk kanë të bëjë asgjë me sigurimin eksportit nga kompania P.- respektivisht dispozitat 899 të LMD-

së ka të bëjë me sigurimin e lundrimit e që në rastin konkret nuk ekziston ky lloj siguriimi. Prandaj edhe ky pretendim i të paditurës është i pabazuar.

Në bazë të nenit 277 par 1 të Ligjit mbi mardhëniet Detyrimore , Gjykata paditësit ia pranoi kamtën prej 3.5% në vit, siq është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimet mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore , ashtu që gjykata paditësit ia aprovoi shpenzimet dhe atë : për parashtres 104 euro , në emër të taksës gjyqësore për propozim për përmbarrim në shumë prej 85 Euro, në emër të taksës për aktgjykim në shumë prej 85 euro, për dy pjesëmarrje në seanca shumë prej 270.4 euro gjithësej shumen prej 544.4 euro, ndërsa sa i përket shpenzimeve për përkthimin e provave Gjykata e refuzoj si të pabazuar ngase pala paditëse ka qenë i obliguar që gjykatës ti dërzoj provat sipas njërës nga gjuhët zyrtare të cilat janë të aplikuar në Republikën e Kosovës.

Andaj, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE

III.C.nr. 553/2012 të dt.29.04.2013

G j y q t a r j a

Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.